



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunication Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije

Nr. Prot. 006/B/11

VENDIM Nr. 166

**Për miratimin e
'Rregullores për Dhënien e Licencës për Radio Stacionet e Mjetit Ajror'**

Bazuar në nenin 4 paragrafi (4) dhe nenin 6 paragrafi (1), të Ligjit mbi Telekomunikacionin Nr. 2002/07, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-085, dhe në referim te nenit 20 të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, Bordi i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART) i përbërë nga,

Bordi i ART-së i përbërë nga,

- 1) z. Ekrem Hoxha, Kryetar
- 2) z. Besnik Berisha, Anëtar
- 3) z. Lulzim Kurtaj, Anëtar
- 4) z. Nijazi Ademaj, Anëtar

në mbledhjen e XXXI të bordit të mbajtur me datë; 30 Janar, 2011 sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Brendshme të ART, pas shqyrtimit final të komenteve dhe sugjerimeve të pranuar gjatë fazës së këshillimit publik, vendosi për miratimin e 'Rregullores për Dhënien e Licencës për Radio Stacionet e Mjetit Ajror'.

Nga diskutimi;

VËREHET se;

- Draft 'Rregullorja për Dhënien e Licencës për Radio Stacionet e Mjetit Ajror', është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës dhe ky dokument shërben që përmes rregullave të përcaktuara në këtë Rregullore të sigurohet ofrimi i shërbimit të stacioneve radio të mjetit ajror mbi bazën e një licence të harmonizuar me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të rekomanduara nga ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve) dhe me Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.
- Përpara paraqitjes për miratim pranë Bordit Drejtues, draft rregullorja sipas vendimit Nr. 150 (Ref. ART Nr. Prot. 067/B/11) ka kaluar në procedurat adekuate të këshillimit të rregullt publik duke respektuar të gjitha afatet dhe procedurat ligjore, si dhe është marr mendimi i zyrës ligjore pranë ART-së.

- Draft rregullorja përcakton kriteret dhe procedurat që zbaton Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART) për dhënien e licencës për stacionet radio të mjetit ajror të regjistruara në Republikën e Kosovës, përdorimin e pajisjeve të tilla duke përfshirë përdorimin e frekuencave dhe përcaktimi i kërkesave teknike për caktimin dhe regjistrimin e shenjës së thirrjes.

ATËHERË:

Me qëllim të;

- implementimit të dispozitave të Ligjit të Telekomunikacionit dhe Ligjit të Aviacionit Civil në Republikën e Kosovës,
- realizimit të zgjidhjeve, të cilat janë plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, direktivat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe praktikatat e mira të shteteve rajonale dhe ndërkombëtare;
- sigurimit të licencës për radio stacionet në përdorim në mjetin ajror për të mundësuar regjistrimin e mjetit ajror pranë autoritetit kompetent në Republikën e Kosovës.

Bordi i ART-së merr këtë,

V E N D I M

- I. Miratimin e 'Rregullores për Dhenien e Licencës për Radio Stacionet e Mjetit Ajror', materialit bashkangjitur këtij vendimi.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i ART-së.

BAZA LIGJORE

Vendimi mbështetet në dispozitat e legjislacionin vijues, qoftë primar apo sekondar.

- 1) Nenet, neni 4 paragrafi (2) dhe (4), neni 6 paragrafi (1) të Ligjit të Telekomunikacionit Nr. 2002/7, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-85,
- 2) Ligjin Nr. 03/L-051 Për Aviacionin Civil,
- 3) Radio Rregulloren e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), vëllim/volume I, edicioni/edition i/of 2004)
- 4) Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar (Convention on International Civil Aviation (1944) 15 U.N.T.S. 295)

Këshilla Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatë kompetent në afatin prej 30 ditësh.

Vërtetim

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ART-së.

Prishtinë, 31/ 01/ 2012

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

**Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit**

Besnik Berisha, Anëtar i Bordit

Nijazi Ademaj, Anëtar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Autoritetit të Aviacioni Civil
- Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave
- Arkivit të ART-së